REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. PSH. Nr. 123/17
Datë/Datum: 01. 03. 2024
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 123/17

Bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit në përbërje nga Vjosa Gradinaj-Mexhuani-Kryetare, Isa Hasani-Anëtar dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 (i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092) duke vendosur sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 1043/17 sipas të cilit është aprovuar kërkesëpadia e paditësit "EuroPrinty dhe është anuluar Vendimi PSH. Nr. 123/17, i datës 30. 05. 2017, i Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me tonera për nevojat e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër të prokurimit 2242/17/45/111, iniciuar nga UP "Hasan Prishtina", në cilësinë e autoritetit kontraktues, me 01.03.2024, mori:

V E N D I M

Rishqyrtohet vendimi i panelit shqyrtues 123/17 për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me tonera për nevojat e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër të prokurimit 2242/17/45/111, iniciuar nga UP "Hasan Prishtina", sipas Aktgjykimit të formës së prerë A.nr. 1043/17 i datës 06. 07. 2021, të Gjykatës Themelore të Prishtinës - Departamenti për Çështje Administrative, i vërtetuar nga Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë, Departamenti Administrativ K. DH. SH. II. nr. 532/22 i datës 12. 10. 2023.

Mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të cituar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, kurse "Europrinty" SHPK ka të drejtë ta inicioj procedurën e kompensimit për dëmin e pretenduar eventual.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30. 01. 2017, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me tonera për nevojat e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër të prokurimit 2242/17/45/111. Autoriteti Kontraktues ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës me datën 11. 04. 2017. Kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët ku kanë marrë pjesë gjashtë (6) operatorë ekonomik.

Me 21. 04. 2017, Operatori Ekonomik "Euro Printy" SHPK ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër vendimit të cituar si më sipër të autoriteti kontraktues, sikurse parashihet me dispozitën e nenit 108/A të LPP.

Me 30. 05. 2017, OSHP mori Vendimin PSh. Nr. 123/17 sipas të cilit ankesa e OE ankues "Euro Printy" SHPK, është aprovuar si pjesërisht e bazuar, ndërkaq është vërtetuar njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së pasiqë paneli shqyrtues ka vlerësuar së pas vlerësimit të të gjitha provave në këtë çështje është vërtetuar se AK ka vepruar ën harmoni me dispozitat e nenit 7, 60 dhe 69 të LPP-së.

- Ankimimi në Gjykatë –

Kundër vendimit të cituar si më sipër të OSHP, operatori ekonomik ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, e cila me Aktgjykimin A.nr. 1043/17, të datës 06. 07. 2022, ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, ka anuluar vendimin e OSHP PSh. Nr. 123/17 dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje tek e paditura OSHP. Në vendimin e kësaj gjykatës ndër të tjera thuhet se vendimi i kontestuar karakterizohet me të meta, për shkak të te cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij të cilat qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 65 të LKA, dhe se vendimi i të paditurës OSHP është i paarsyetuar dhe nga vendimi i të paditurës nuk arrihet të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike në këtë procedurë të prokurimit.
Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë është atakuar me Ankesë nga OSHP në afatin ligjor, e cila ankesë është shqyrtuar nga Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë- Departamenti Administrativ K. DH. SH. II. nr. 532/22 i datës 12. 10. 2023, dhe është refuzuar si e pabazuar, ndërkaq është vërtetuar vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Nga ana tjetër, Bordit të OSHP-së (në përbërjen paraprake) i kishte skaduar mandati që me datën 01 prill 2021 kurse Bordi në përbërje aktuale është emëruar në qershor 2022, kështu që një numër i konsiderueshëm i lëndëve kishin ngelur pritje të shqyrtimit andaj edhe Aktgjykimi në rastin konkret i Gjykatës Komerciale, shkaqe objektive nuk ka gjetur zbatim në kohë efektive. Megjithatë, OSHP ka emëruar një ekspert për shqyrtimin e rrjedhës së kësaj çështje i cili ka konstatuar se mbi bazë e të gjithë dokumentacionit në rastin konkret duhet të zbatohet vendimi i Gjykatës Kompetente duke lënë në fuqi vendimin e AK-së për shkak se kontrata në këtë aktivitet sipas afateve të parapara me LPP tashmë ka përfunduar.

- Përfundim -

Bordi i OSHP, analizoj vendimet e gjykatës, arsyet dhe faktet për të cilat është ekzekutuar ky aktivitet i prokurimit dhe konstaton se ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar dhe ka përfunduar në vitin 2017. Nga ana tjetër, nisur nga karakteri dhe efektet juridike të aktgjykimit të formës së prerë dhe duke vepruar sipas tij, Bordi konsideron se çështja duhet kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura, OSHP, megjithatë përballet me faktin se ky është një aktivitet i përfunduar andaj edhe sikur lënda te kthehet në rivlerësim tek autoriteti kontraktues, respektivisht sikurse te kthehej në piken zero, nuk do

te kishte kurrfarë efekti pasi qe ky aktivitet ka përfunduar vite me parë. Mirëpo ankuesi ka të drejtë që ti drejtohet gjykatës kompetente lidhur me vërtetimin e faktit, nëse i njëjti është dëmtuar apo jo.

Bordi i OSHP, administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe i analizoi secilën nga to dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me kompetencat e parapara me nenin 98, 99 lidhur me nenin 104 dhe 105 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit

Në emër të Bordit
Vjosa Gradinaj-Mexhuani, Kryetare

Këshillë Juridike:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet me kërkesëpadi Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike - Dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues
- Ankuesit, OE "Europrinty"
- Dhe, Për publikim në faqen zyrtare